

**PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE VLERESIMIT
TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER
AKTIVITETIN "IMPIANT PASURIMI KROMI"
ME ZHVILLUES "FENI - CROME ALBANIA" SHPK
NJESIA ADMINISTRATIVE RRAJCE, BASHKIA PREENJAS**



Eksperte Mjedisore

Ing. Lila Karaj

Kimist teknolog Beqir KLLA



PERMBAJTJA E LENDES

Permbledhje e Raportit Paraprak i VNM-se

- a. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi.....
- b. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij.....
- c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.....
- ç. Një përshkrim për shkarkimet e mundëshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe përdorimi i mbetjeve. Shkarkimet e mundëshme në mjedis si ujra të ndotur, gazra, pluhra, zhurma, vibrime, prodhimi i mbetjeve.....
- d. Informacion për kohëzgjatjen e mundëshme të ndikimeve negative të identifikuara për aktivitetin "Impiant Pasurimi Kromi" Rrajcë, Bashkia Prrenjas
- dh. Të dhëna për shtrirjen e mundshme negative të ndikimeve negative në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.....
- e. Mundësitë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.....
- ë. Masat e mundëshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.....
- f. Ndikimet e mundëshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).....

Hyrje

Shoqëria "FENI-CROME ALBANIA" sh.p.k zhvillon aktivitetin e nxjerrjes së mineraleve nga minierat e Prrenjasit. Ajo është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT L18414601Q, e përfaqësuar nga Aleksandër Beqo, administrator i vetëm i shoqërisë, me adresë : "Qukës", Prrenjas Qendër, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas.

Pronari, Bashkia Prrenjas, me qëllim që të zhvillojë ekonominë dhe të nxisë punësimin në territorin e administruar prej saj, ka hyrë në një marrëveshje enfiteoze me shoqërinë " FENI-CROME ALBANIA" për ngritjen e një njësie shërbimi për ushtrimin e aktiviteteve si: grumbullimin, pasurimin e kromit të varfër etj, duke dhënë me qera pronë, një sipërfaqe trualli e llojit "shesh miniere" me sipërfaqe 0,004 km² në Njësinë Administrative Rrajcë" fshati Katjel, sipas kontratës Nr. 1899 Prot. dt 27.07.2016 për dhënie me Enfiteozë të pasurisë me Nr. 2112/1, ZK 2116, e llojit "shkëmbore" me sipërfaqe totale 20526 m² dhe pasurisë Nr. 256/5 Zk 2116 e llojit "shesh miniere me sipërfaqe 0.004 km² me pronar shtet, në njësinë Administrative Rrajcë.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis përfshin **ndikimet** pozitive dhe negative mjedisore në mjedisin fizik dhe human për aktivitetin , Impiant Pasurimi Kromi", në pronën me pronar Bashkinë Prrenjas dhe zhvillues shoqërinë "FENI-CROME ALBANIA" shpk.

a.1 Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e projektit

Për zgjidhjen e projektit për "Impiant Pasurimi Kromi", Bashkia Prrenjas, teknologjinë e zbatimit të punimeve të ndërtimit, mobilimin urbanistik të zonës së studiuar, dhe shfrytëzimit projektuesit janë mbështetur në ligjislacionin mjedisor të miratuar në Republikën e Shqipërisë dhe rregulloret e ndryshme për mjedisin. Gjithashtu shoqëritë ndërtuese që do të zbatojnë punimet dhe projektin do të marrin përsipër të zbatojnë me korrektesi normat e përmirësuara në të ardhmen në drejtim të ndotjes së mjedisit.

Në kuadrin aktual ligjor për VNM -nëkryesoret janë:

- **Ligji Nr.10431, datë 09.06.2011, në nenin 26 të tij** "Për mbrojtjen e mjedisit"

Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky ligj përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

- **Ligji Nr.10 440, datë 07.07. 2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"**

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

a) një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;

b) garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të. Në të përcaktohen dhe natyra e procesit të shqyrtimit të VNM

a) procesi i thelluar i VNM b) procesi i përmbledhur.

KREU II

PROÇEDURAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Neni 7

Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis

1. Projektet private apo publike, të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II-^{le} të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse, nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

2. Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) **procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

b) **procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.**

3. Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së, është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

a) **raporti paraprak i VNM-së, për projektet e shtojcës II;**

b) **raporti i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës I.**

Studimi përfshihet në Shtojcën II, "Projekte që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis pika 10 : Produkte infrastrukture. a) Projekte për zhvillimin e Pasurive të Patundëshme Industriale.

- **Vendimin Nr.686 datë 29.07.2015** "Për miratimin e rregullave të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore".

- **Ligji Nr.10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit".**

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës. Përcakton detyrimet për Pajisjen me Leje Mjedisore të subjekteve fizike dhe juridike që kërkojnë të ushtrojnë një veprimtari që ka ndikime në mjedis. Kreu IV i këtij ligji "Leja për veprimtaritë që ndikojnë në mjedis" Nenet 35-48 përcaktojnë modalitetet e marrjes së lejes mjedisore.

- **Ligji Nr.10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"**

Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë mjedisin e shëndetin e njeriut dhe të sigurojë menaxhimin e duhur mjedisorë të mbetjeve nëpërmjet:

- a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve.
- b) përmirësimit të efikasitetit të përdorimit të tyre.
- c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2003 "Për administrimin mjedisor të Mbetjeve të Ngurta".

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme.

- Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për Trajtimin Mjedisor të Ujërave të Ndotur"

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë mjedisin dhe shëndetin e njeriut nga ndikimet negative të ujërave të ndotura, duke përcaktuar rregullat e trajtimit mjedisor të tyre, si dhe detyrimet e shkarkuesve të ujërave të ndotura.

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

- a) ujërat e ndotura urbane; b) ujërat e ndotura industriale, sipas degëve të veçanta të industrisë; c) ujërat nga kullimi i tokave bujqësore; ç) ujërat e ndotura të çdo lloji.

Në përputhje me kërkesat e këtij ligji, personat fizikë dhe juridike duhet të marrin masa që të ulin në vijimësi sasinë e ujërave të përdorura, që shkarkojnë në mjedisin pritës dhe të pakësojnë shkallën e ndotjes së ujërave që shkarkojnë, sidomos të ndotjeve me lëndë e mbetje të rrezikshme (shkronja a dhe b e pikës 1 të nenit 6).

Ligji Nr.9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis"

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit nga zhurmat, duke përcaktuar mënyrën e shmangies dhe masat për parandalimin, reduktimin dhe zhdukjen e efekteve të dëmshme të ekspozimit ndaj tyre, përfshirë bezdinë nga zhurma. Ligji zbatohet për zhurmën, ndaj së cilës njerëzit ekspozohen në mjedisin ku ndodhen (mjediset e zonave të banimit, institucionet e ndryshme, zonat me aktivitet social-ekonomi, mjedise urbane dhe parqet publike). Ligji nuk zbatohet për zhurmën e lëshuar brenda vendeve të punës.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit. Kështu, ndër më specifikët mund të përmendim:

- Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit"
- Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001, "Të mbrojtjes ndaj zjarrit".
- Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike".
- Ligji Nr.9290, datë 07.10.2004, "Për produktet e ndërtimit".
- V.K.M. Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit".
- V.K.M. Nr. 435, datë 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".
- V.K.M. Nr. 249, datë 24.04.2003, "Për dokumentacionin për Leje Mjedisore dhe të elementëve të Lejes Mjedisore".
- VKM Nr. 268, datë 24.04.2003, "Për çertifikimin e specialistëve, për V.N.M. dhe auditimin mjedisor".
- V.K.M. Nr. 177, datë 31.05.2005, "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjedisëve ujore pritëse".

- Udhezimi Nr.429, datë 17.11.2009, i Ministrit të Mjedisit, "Për rregullat dhe procedurat për paisjen me leje mjedisi në kuadër të Qendrës Kombëtare të Liçensimit".
- V.K.M.Nr.587, datë 07.07.2010, "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike".
- Udhëzimin Nr.8, datë 27.11.2007, "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara.
- Ligji Nr.8906 datë 6.6.2002 "Për Zonat e Mbrojtura i azhornuar me ligjin nr.9868 datë 04.02.2008

Vendndodhja e objektit

Prona që zhvillohet ndodhet në fshatin Katjel, në jug të Njësisë Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas. Ajo është rregjistruar në Zyrën e Pasurive të Paluejtshme Librazhd, si pronë shtetërore dhe i është dhënë me kontratë Nr. 1899 Prot. dt 27.07.2016 me Enfiteozë të pasurisë me Nr. 2112/1, ZK 2116, e llojit "shkëmbore" me sipërfaqe totale 20526 m² dhe pasurisë Nr. 256/5 Zk 2116 e llojit "shesh miniere me sipërfaqe 0.004 km² me pronar shtet, shoqërisë "FENI-CROME ALBANIA".

Tabela Kufizimet e pronës

Veri	1612/1
Lindje	256/5; 2112/14
Jug	2112/11
Perëndim	2112/10

Aktualisht ky shesh është i lirë dhe i parashikuar për ngritjen e impiantit të pasurimit të kromit. Ai ka nevojë për punime gjurmimi, nivelimi dhe prishjen e një ure të vjetër që të çon në minierat e vjetra të hekurit dhe kromit të Katjelit. Volumi i objektit është i konsiderueshëm dhe investitori duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që të mos krijojë ndotjen e ambjentit me mbetje ndërtimore që do të krijohen nga punimet e prishjes së urës, gjurmimeve, dhe nivelimit të sheshit si dhe betonimeve për të krijuar bazamentet e makinerive, sipas planvendosjes së miratuar nga Bashkia Prrenjas.

Koordinatat e kufirit të pronës dhe objektit për "Godinë 1 Kat, Impiant Pasurimi Kromi", në projektionin GAUS-KRYGER janë si më poshtë:

Tabela Koordinatat e pronës

Pikat	X	Y
1	4463776.16	4545458.85
2	4463801.29	4545479.62
3	4463822.95	4545435.02
4	4463858.86	4545353.51
5	4463837.45	4545356.32
6	4463797.88	4545427.96

Foto Pamje nga zona ku do të ndërtohet Impianti për Pasurimin e Kromit, Katjel në foton ajrore të zonës




Foto Pamje të zonës ku do të ndërtohet Impianti për Pasurimin e Kromit, Katjel



Foto Harta Treguese e Pasurisë sipas Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Prrenjas

Raporti i VNM për „ Impiant Pasurimi Kromi”, Katjel, Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas ka për qëllim të shërbejë si instrument:

- Në identifikimin e ndikimeve negative dhe lokale.
- Në marrjen e masave zbutëse duke patur parasysh ndërhyrjen në zonë me punime ndërtimore, interesave ekonomike sociale dhe kulturore të investimit në fushën e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të Industrisë Minerare.
- Në marrjen e masave orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit në Njësinë Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas.
- Për rritjen e nivelit në fushën e ndërtimit dhe funksionimit të plotë të objektit “Godinë 1 Kat, Impiant Pasurimi Kromi” Bashkia Prrenjas me standarte bashkëkohore.
- Për plotësimin e kërkesave dhe nevojave të investitorit dhe pronarit të objektit për rritjen e shërbimit dhe shtimit të produkteve industriale minerale dhe rritjen e nivelit të biznesit të investitorit dhe të jetesës së popullsisë së zonës ku realizohet ky investim.

a. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet projekti “Impiant Pasurimi Kromi” Njësia Administrative Rrajcë, Bashkia Prrenjas, shoqëruar dhe me fotografi.

Gjatë punimeve ndërtimore për ngritjen e objektit 1 kat të kaponit industrial, do të ketë një sërë ndikimesh direkte apo indirekte të tilla si: pastrime të bimësisë sheshin e zonës ku ndërtohet, gjurmime dhe spostime dheu dhe shkëmbi në sasi të konsiderueshme për krijimin e bazamentit të kaponit dhe të konstruksionit mbajtës në përgjithësi dhe nivelimin e kuotave natyrale me ato të projektit, betonimi i themeleve e kollonave b/a dhe prishja e bimësisë në tokën ku ndërhyhet. Ndotja e ajrit, zhurmat dhe tronditjet e tokës për shkak të ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit mund të kenë impakt në migrimin e faunës nga sheshi i ndërtimit.

Vegjetacioni në zonën e objektit. Pjesa më e madhe e zonës ku realizohet ky projekt është me karakter shkëmbor dhe larg qendrave të banuara. Pranë zonës ndodhen sipërfaqe të mëdha shkëmbore pothuajse të zhveshura nga bimësia të fshatit Katjel, shkurre të shkurtra , karakteristike për këtë zonë shkëmbore ndërsa në territorin ku do të ndërtohet, sipërfaqja është e lirë dhe pa objekte.

Foto Pamje nga bimësia e zonës ku do të ndërtohet objekti “Godinë 1 Kat, Impiant Pasurimi Kromi”



Në tërësi në pronën ku do të ndërtohet objekti "Godinë 1 Kat, Impiant Pasurimi Kromi" mungon vegjetacioni, ndërsa në zonën pranë, është i kultivuar dhe me dentësi mesatare të masës bimore. Zona ndodhet midis kodrave shkëmbore të Katjelit ku bimësia është mjaft e rrallë dhe e egër, pasqyrim I formacioneve shkëmbore minerare të Njesisë Administrative Rrajcë. Llojet bimore më frekvente janë ato të zonës së Prrenjasit. Në sipërfaqen që do të zhvillohet janë të planifikuara për t'u mbjellë me pemë të ndryshme të zonës.

Fauna. Aspekti faunistik është i lidhur ngushtë me mjedisin rrethues. Ai paraqet një larmi biologjike mjaft të varfër, që është po kështu një pasqyrim i gjendjes së këtij ekosistemi industrial minerar dhe të faunës pranë përrenjve të kodrave të Katjelit.

Gërmimet arkeologjike tregojnë se në këtë zonë nuk ka zbulime arkeologjike, por kjo nuk përjashton çdo zbulim të mundshëm të prezencave arkeologjike. Vendi i zgjedhur për ndërtimin e objektit dhe zona përreth, siç u përshkrua me lart nuk përmban vlera natyrore të veçanta dhe të shpallura të mbrojtura.

b. Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij

Hidrologjia, ujrë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.

Përsa i përket hidrologjisë ajo është e shprehur në rajone me ujra nëntokësore dhe ujra sipërfaqësore. Ujrë sipërfaqësore janë ato të ujrave të shiut ose të proskave që rrjedhin në drejtim të përroit të Katjelit dhe që zbresin poshtë në mënyrë natyrore. Ujrë nëntokësore nuk preken gjatë ndërtimeve të objektit 1 kat ndërsa ato mbitokësorë sistemohen në kanalizime aty ku është e nevojshme.

Hidrogjeologjia. Sasia mesatare e rreshjeve vjetore dhe e rreshjeve të dëborës furnizon një rrjet hidrografik të mirë në Lumin e Shkumbinit.

Pothuajse të gjitha tokat e kësaj Njësie Administrative janë brenda sistemit të ujitjes kjo edhe për arsye të terrenit të sheshtë të fushës dhe pjerrësisë së butë të kodrave që rrethojnë fushën. Gjithashtu pranë tokave dhe në afërsi të sipërfaqes që zhvillohet kalon kanali i ujitjes vjen nga burimet e Qafë Thanës. Për arsye të konfiguracionit ujrë sipërfaqësore qëndrojnë dhe

grumbullohen në kanale kullimi të zonës. Ndërtimi i "Godinës 1 Kat, Implant Pasurimi Kromi" nuk i prek këto burime ujore.

c. Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundëshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër

Nisur nga vlerësimi i projektit për zbatimin e punimeve të projektit "Godinë 1 Kat, Implant Pasurimi Kromi", veçorive kryesore të projektit dhe inspektimit në vend të sipërfaqes ku do të kryhen punime ndërtimore, është bërë identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundëshme në mjedis, që do të jenë gjatë kryerjes së punimeve dhe shfrytëzimit të kësaj zone minerale pas përfundimit të punimeve. Në përputhje me Udhëzimin nr.6 datë 27/12/2006 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit paraprak të ndikimit në mjedis të një veprimtarie" me këto identifikime dhe vlerësime është plotësuar tabela I e aneksit II të këtij udhëzimi për të analizuar në mënyrë të detajuar vlerësimet sasiore të ndikimeve në mjedis nga zbatimi i projektit: "Godinë 1 Kat, Implant Pasurimi Kromi" Rrajcë, Bashkia Prrenjës.

KLASIFIKIMI I RAPORTIT TE VLERESIMIT NE MJEDIS PER PROJEKTIN

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
1.1	Ndryshime te perkohshme ose perhershme me perdorim toke, topografi etj.	Jo	Nuk ka ndikim ne perdorim toke bujqesore as topografi. Njekohesisht objekti nuk ka afer objekte kulturore e historike, zona rekreative etj.	
1.2	Pastrim tokes ekzistuese, vegjetacionit e ndertimeve	Po	Ndikim pjesor ne pastrim per punime. Eshte zone pothuajse e zhveshur nga bimesia, ish zone e qytezes se minatoreve	Ndikim provizor e minimal
1.3	Krijimin e perdorimeve te reja te tokes	Jo	Pervec sa me siper	
1.4	Investigime , marrje mostre, shpime etj.	Jo		
1.5	Punime ndertimi	Po	Ndikim te perkohshem ne peisazh, gjate ndertimit. Nuk ka afer objekte te tilla, spitale, shkolla etj. as qender te banuar	Ndikim provizor sepse do te behen sistemime e rehabilitime
1.6	Punime prishje	Jo		
1.7	Karriere e perkohshme per punime, apo strehim i perkohshem per punetoret	Jo		
1.8	Punime mbitokesore te tokes, germime, mbushje etj.	Po	Ndikime provizore ne peisazh, pa demtim siperfaqe te pyllezuar.	Ndikim minimal e i perkoheshem sepse do te behet sistemim e

			Theksojme se nuk ka zona me status te veçante mbrojtje	rehabilitim
1.9	Punime netoksore	Jo		
1.10	Punime bonifikuese	Jo		
1.11	Germime per hapje kanalesh	Po	Ne sistemim te ujrave siperfaqesore etj	Pa ndikim ne zone
1.12	Struktura bregdetare, diga etj.	jo	Nuk ka afer zona te tilla	
1.13	Struktura ne det	Jo	Nuk ka afer zona te tilla	
1.14	Procese te ndryshme prodhimi	Po	Pa ndikim ne mjedisin perreth sepse eshte larg zones se banuar, e do te zbatoje parametrat e normat per perhapjen e zhurmes, pluhurit etj.	Nuk ka ndikim ne mjedisin perreth
1.15	Mjedise per magazinim mallrash e materialesh	Po	Nuk shoqerohen me ndikim ne mjedis, sepse do te zbatohen kerkesat ligjore per depozitim, ruajtje e perdorim.	
1.16	Objekte per strehim afatgjate te punonjesve	Jo		
1.17	Impjante per trajtimin dhe depozitim e mbet. Ngurta ose lengeta	Po	Parashikohet ndertim dambe per mbetjet e ngurta me projekt tip, e masa mbrojtese ndaj ujrave erozionit etj.	Nese zbatohen kerkesat e projektit e ato ligjore nuk ka ndikim negativ
1.18	Rruge e re, trafik detar, hekurudhor gjate ndertimit ose shfrytezimit.	Po	Pa ndikim ne infrastruktura aktuale.Kjo sepse rreth 50 m rruge lidhese nga linja ne rrugen lokale., nuk nderpret apo demton ndonje rruge aktuale as perspektive	Pa ndikim gjate ndertimit, ne trafikun rrugor etj.
1.19	Rruge e re, ajrore, ujore etj	Jo		
1.20	Mbyllje ose devijim rruge ekzistuese, me ndikim ne trafik	Jo		
1.21	Linja ose tubacione te reja per transmetim	Po	Ndikim minimal e pjesor, vetem gjate fazes se ndertimit	Ndikim te perkohshem sepse do te zbatohen masat ligjore
1.22	Rezervuare, argjinatura, kanale anesore apo ndryshime te tjera ne	Jo		

	hidrogjine e mjedisve ujore apo akuifereve			
1.23	Nderprerje te rrymave	Jo		
1.24	Nxjerrje ose transferim te ujit nga nentoka apo siperfaqe	Po	Me instalim pompe ne mjedis uJOR ne afersi te objektit me rreth 5 l/sek, per nevoja teknologjike, por pa ndikim ne zone	
1.25	Ndryshime ne trupa ujore apo siperfaqe me ndikim ne drenazhim apo largim ujrash	Jo		
1.26	Transport personeli apo materialesh e mbeturinash	Po	Pa ndonje ndikim ne trafik etj, sepse jane sasira jo te medha	
1.27	Punime afatgjata zmontimi, per nxjerrje te mbeturinave te veprimtarise apo punime restauruese	Jo		
1.28	Hyrjen e njerzve ne nje zone perkohesisht ose menyre te vazhdueshme	Po	Pa ndikim sepse do te jene vetem gjate punes Nuk ka afer zone pushimi, apo rekreative te veçante. Njekohesisht nuk ka ne afersi objekte te rendesie si spitale, shkolla etj.	Nuk ka ndikim
1.29	Veprimtari gjate ndryshimit te destinacionit, me ndikim ne mjedis	Jo		
1.30	Futjen per kultivim te specieve jo vendase	Jo		
1.31	Humbjen e specieve vendase apo deversitet gjenerik	Jo		
1.32	Ndonje veprim tjeter			

2. Perdorimi i burimeve gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te projektit

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
2.1	Toka veçanerisht e varfer apo bujqesore	Po	Projekti zbatohet ne nje zone jo te zhvilluar me pare.	Nuk ndodhin ndryshime te medha ne

			Perdor toke inproduktive, pa ndikim ne siperfaqen e tokes bujqesore. Theksojme se kjo siperfaqe eshte e zhveshur, e nuk perben ndonje element te rendesishem formacioni geologjik e paleontologjik, apo objekt tjetër me status mbrojtje.	mjedis. Pasojat jane te perkohshme sepse sipas planit do te kemi sistemime e rehabilitime. Keto do te ndikojne ne peisazhin e zones.
2.2	Uje	Po	Ne sasira te tilla pa ndonje ndikim sepse nuk ka perdorues te ketyre burimeve . Zona e banuar eshte shume larg objektit	Parashikohet riciklim te nje sasive uji industrial pas dekantimit te materialeve ne damben e depozitimit
2.3	Minerale	Po	Shfrytezohen minerale kromi te varfer per pasurim sipas projektit, ne perputhje me kerkesat ligjore e masat per uljen e ndikimit ne mjedis.	Nuk ka ndikim ne rezervat etj. sepse vendi ka shume te tilla e shfrytezohen sipas ligjit
2.4	Materiale ndertimi si rere e zhavorre	Po	Ne fazen e ndertimit, sipas nje projekti	
2.5	Energji elektrike, lende djegese	Po	Ka rreth 1,5 milion kwh konsum vjetor energjie, e rreth 60 mije litra karborante, per mjete	Pa ndikim ne zone.
2.6	Pyje dhe lende drusore	Jo	Nuk demton siperfaqe te pyllezuar	Do te monitorohet ne fazen e ndertimit nga strukturat e pyjeve

3- Perdorim, ruajtje, transport, perpunimin dhe prodhimin e substancave ose materialeve qe mund te jene te demshme per shendetin e njerezve dhe mjedisin.

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
3.1	Substanca toksike e te rrezikshme	Jo		
3.2	Shfaqie semundjesh nga insektet ose infektimet e ujrave	Jo		
3.3	Do te ndryshoje projekti ne mardheniet e njerezve, psh. Ndryshim kushte jetese	Po	Ndikon ne rritjen e punesimit ne zone, e rrjedhimisht edhe cilesi jetese	Ndikim per zonen por se bashku me projekte te tjere, siguron nje ndikim te perhershem
3.4	Grupe te veçante qe ndikohen si paciente	Jo		

spitalesh etj.			
----------------	--	--	--

4- Mbetjet e ngurta gjate zbatimit, shfrytezimit ose nxjerrjes jashte funksionit

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
4.1	Mbeturina dherash, zhavorresh apo mineralesh	Po	Pa ndikim ne peisazh e ne cilesine e ajrit (nga grimcat e pluhurit) kryesisht gjate fazes se ndertimit madje edhe shfrytezimit, sepse aplikohet uji ne sheshin e lendes pare. Dherat do te sistemohen sipas terrenit pa cenuar peisazhin perreth	Ndikim provizor e pa pasoja ne popullate e zone, sepse do te zbatohen detyrimet ligjore, per evitim te tyre
4.2	Mbetje urbane, (shtepiake apo tregetia)	Po	Pa ndikim sepse jane sasi minimale qe perdoren nga personeli i punes ne ndertim e zbatim	Nuk ka ndikim sepse do te zbatohen kerkesat per administrimin
4.3	Mbetje toksike, te rrezikshme apo radiaktive	Jo		
4.4	Mbetje toksike, te rrezikshme apo radiaktive	po	Ndikim provizor ne toke, Te mases se ngurte e cila sistemohet ne damben perkatese e cila monitorohet e mirembahet me korektese.	Ndikim minimal, pasi do te kontrollohet cilesia e ujrave etj
4.5	Produkte shtese	Jo		
4.6	Ujra te zeza ose llumra gjate trajtimit te shkarkimeve te lengeta	Po	Sasi minimale me ndikim te perkohshem ne toke, nese nuk administrohen sipas ligjit	Ndikim provizor e minimal sepse veprimtaria eshte e tille, si dhe do te zbatohen kerkesat ligjore te parashikuara ne kete raport
4.7	Mbetje nga ndertimet ose shembjet	Po	Sasi minimale me ndikim te perkohshem ne toke, nese nuk administrohen sipas ligjit	Ndikim provizor e minimal sepse veprimtaria eshte e tille, si dhe do te zbatohen kerkesat ligjore te parashikuara ne kete raport
4.8	Mbeturina makinerish ose paisjesh	Jo	Do te zbatohen me korektese proceset ne riparime mjetesh, makineri – paisjesh, per te sistemuar e administruar pjeset skarco, lubrifikantet etj.	

-5- Shkarkimet ne ajer te ndotesve apo substancave te rrezikshme per shendetin .

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
5.1	Shkarkime nga djegia e karburanteve	Po	Nga mjetet e levizshme ne punet e ndertimit, si dhe shfrytezimit. Ndikim ne cilesine e ajrit ne afersi te objektit te punes. Per kete subjekti do te kerkoje zbatimin e normave te shkarkimeve te tyre sipas ligjit mjedisor. Theksojme se nuk ka ne afersi objekte te vecanta si shkolla, spitale, shtepi banimi etj.	Ndikim provizor, e minimal per punonjesit, sepse nuk ka afer zona te banuara, spitale, etj. Te kontrollohet zbatimi per normat.
5.2	Nga procese prodhimi	Jo	Subjekti do te aplikojte lagien me uje sepse e tille eshte teknologjia, krahas faktit se veprimtaria eshte ne mjedise brenda jo ne teren te hapur	Ndikimi i paperfillshem per mjedisin.
5.3	Nga perpunim materiali, transport, depozitim	Po	Ndikim minimal ne cilesine e ajrit nga pluhurat. Per kete subjekti do te zbatoje metodat efikase per pakesimin e tyre, sidoemos ne kohen e thate, me sperkatje uji, mbulim te ngarkeses me mushama etj	Ndikim minimal brenda normave ligjore
5.4	Nga aktivitetet e ndertimit	Po	Ndikim minimal ne cilesine e ajrit nga pluhurat. Per kete subjekti do te zbatoje metodat efikase per pakesimin e tyre, sidoemos ne kohen e thate, me sperkatje uji, mbulim te ngarkeses me mushama etj	Ndikim minimal brenda normave ligjore
5.5	Nga erezat e keqia te perpunimit te materialeve apo ujrave te zeza	Jo		
5.6	Shkarkime nga inceneratoret e plehrave	Jo		
5.7	Shkarkime nga djegie e mbetjeve ne ajer	Jo		
5.8	Shkarkime nga burime te tjera	Jo		

-6- Ndikimi nga zhurmat, vibracionet, rrezatimet elektromagnetike, te drites, energji termike .

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
6.1	Puna e paisjeve, motorra etj.	Po	Ndikim vetem per punonjesit, sepse, objekti eshte larg zonave te populluara Kjo nga puna ndertimore me mjetet e transportit, si dhe makinerite gjate fazes se shfrytezimit . Nuk ka afer objekte social – kulturore, spitale, etj.	Ndikim minimal dhe i perkohshem, vetem per punonjesit, per te cilen subjekti duhet te paise me mjete mbrojtese individuale e kontroll periodik shendetesor te personelit
6.2	Nga proceset industriale ose te ngjashme		Ndikim vetem ne mjedisin e punes nga veprimtaria e mjetet e ngarkimit e transportit, Nuk ka ne afersi objekte si shkolla, spitale, banesa te populluara	Ndikimi nga zhurmat dhe vibracionet ne rastin e punes ne sita mendohet brenda normave. Per kete subjekti duhet te zbatoje kerkesat ligjore e disa rekomandime te dhena ne raport. Duhet kontroll periodik shendetesor
6.3	Nga ndertime apo prishje	Jo		
6.4	Nga trafiku gjate ndertimit dhe shfrytezimit	Po	Ndikim minimal vetem per punonjesit e jo zonen Nuk ka ne afersi objekte banimi e social-kulturore apo vende pushimi	Ndikim provizor, e brenda standartit
6.5	Nga sistemet e ndriçimit dhe ftohjes	Jo		
6.6	Nga burimet e rrezatimit elektromagnetik	Jo		
6.7	Nga plasje apo futje pilotash	Jo		
6.8	Nga çdo burim tjetër	Jo		

-7- Ndikimet nga shkarkimet ne toke dhe uje

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes

7.1	Nga perpunimi, depozitimi, perdorimi, shkarkimi i materialeve te rrezikshme ose toksike	Jo	Nuk parashikohen materiale te tilla	
7.2	Nga ujrat e zeza apo rrjedhjeve te tjera te trajtuara	Jo	Projekti parashikon masa te plote per shkarkime te tilla higjeno-sanitare, siç trajtuam me siper me aplikim gropa septike, per rrethana provizore.	
7.3	Depozitimi i ndotesve te shkarkuar ne ajer uje dhe toke	Jo	Parashikohet zbatim korekte te masave siç jepen ne kete raport te pershkruara	
7.4	Nga çdo burim tjetër	Jo		
7.5	Rrezik nga akumulim afatgjate te ndotesve ne mjedis	Jo		

-8- Rreziku i aksidenteve gjate ndertimit dhe shfrytezimit te projektit qe mund te ndikojne ne shendetin e njerezve apo mjedis.

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
8.1	Nga shperthime , zjarre	Jo	Procesi eshte i tille qe nuk ka kushte per shperthime apo zjarre. Megjithate projekti do te siguroje edhe masa mbrojtese ndaj ndonje situatë zjarri	
8.2	Nga depozitimi e perpunimi i substancave te rrezikshme ose toksike	Jo		
8.3	Nga ngjarje qe kaperejne kufinjte e mbrojtjes minimale te mjedisit, si demtim i sistemit te kontrollit te ndotjes etj.	Jo		
8.4	Nga ndonje shkak tjetër	Po	Jane trajtuar ne fazen e zbatimit dhe shfrytezimit fenomene qe lidhen me zbatimin e kerkesave per sigurine ne pune	Ndikim spontane ne punonjesit e objektit jo ne mjedis e popullaten perreth
8.5	Deme nga fatkeqesi natyrore, si permytje, termete et.	Jo	Zona eshte studiuar per strukturen e formacionin gjeologjik etj. Projekti parashikon zgjidhje ne	Per permytjet nese nuk zbatohen regullat e percaktuara ne kete

			vartesi te ketyre te dhenave	veprimtari
--	--	--	------------------------------	------------

-9- Ndryshime sociale nga projekti, demografi, menyre rracionale jetese, punesim.

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
9.1	Ndryshime ne moshen e popullates, moshen etj.	Jo		
9.2	Nga sterhimi, apo prishje objektesh, shkolla, spitale etj.	Jo		
9.3	Nga realizimi i kerkesave ne rritje si strehim, arsim	Jo		
9.4	Nga krijimi i vendeve te punes gjate ndertimit dhe shfrytezimit	Po	Ndikim ne zbutje te problemit social, me punesim sezonal gjate ndertimit si dhe gjate shfrytezimit	Ndikim pozitiv qe jepet tek kapitulli i organizimit e monitorimit
9.5	Nepermjet migrimit te banoreve te rinj apo krijim komunitetesh te reja	Jo		
9.6.	Ndonje shkak tjeter	Jo		

-10- Ndikim nga projekte te tjera ne infrastrukturen e zones etj. si banesa, rruge te reja ose veprimtari mbeshtetese.

Nr.	Emertime te ndikimit	Po ose Jo	Cilet elemente ndikohen dhe si	Do te jete ndikimi domethenes
10.1	Do te çojë projekti ne presione per zhvillime qe do kene ndikim ne mjedis, si me shume rruge, banesa industri etj.	Jo		
10.2	Do te çojë projekti ne zhvillime te tjera si : -Infrastrukture mbeshtetese, rruge, furnizim me energji, trajtim ujrash te perdorur etj. -Zhvillim strehimi	Po	Nga procesi i pasurimit rritet interesi per shfrytezim e mundesi perpunimi edhe te kromit te varfer	Pa ndikim ne mjedis

	-Industri nxjerrese -Industri furnizuese etj.		
10.3	A kemi riperdorim kantjeri	Jo	
10.4	A ka precedente per zhvillime te mevonshme	Jo	
